



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ZONAVE TË MBROJTURA

Thirrje për aplikim:

A. 1 Roje Mjedisore/Ranger assistant pranë AdZM Dibër/PNKK

Nga: Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)
Adresa: Blvd.Dëshmorët e Kombit, Nr. 1, Tiranë,
www.turizmi.gov.al

Kontakte: Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)
e-mail: Info@akzm.gov.al

Date: 02.09.2024

Titujt vakant:

Referenca.: A. 1 Roje Mjedisore/ Ranger assistant pranë AdZM Dibër/PNKK
Rezultati 2, Aktiviteti 2.1 (Pozicioni 1A) sipas projektit të financuar nga PONT dhe zbatuar nga AKZM

1. Hyrje

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) është autoriteti qeveritar përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të zonave të mbrojtura në Shqipëri. AKZM operon nëpërmjet 12 Administratave Rajonale për Zonat e Mbrojtura (AdZM) të cilat janë drejtpërdrejt përgjegjëse për menaxhimin në terren dhe monitorimin e zonave të mbrojtura brenda territorit të rajonit të tyre. AdZM përbëhet kryesisht nga një sektor monitorimi dhe një sektor menaxhimi i mbështetur nga një numër rojesh të dedikuara për çdo zonë të mbrojtur dhe kryesisht përgjegjës për patrullimin në terren.

Prespa Ohrid Nature Trust (PONT) është një fond mirëbesimi ndërkufitar i krijuar në vitin 2015 nga Fondacioni MAVA dhe nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) me misionin “Ruajtja e natyrës për një të ardhme të qëndrueshme përmes krijimit të partneriteteve dhe mbështetjes financiare afatgjatë”. PONT zbaton misionin e tij nëpërmjet dy programeve kryesore të granteve: (1) bashkëfinancimi i kostove operacionale të Zonave të Mbrojtura dhe (2) bashkëfinancimi i punës së Aktorëve Mjedisorë. Aktorët Mjedisorë përfshijnë organizatat jofitimprurëse (OJF) me fokus mbrojtjen e natyrës, bashkitë, institucionet shkencore dhe akademike. Për më shumë informacion ju lutemi na vizitoni në: www.pont.org.

Zbatimi i grantit 3-vjeçar është në vitin e parë të tij (2024) dhe sipas planit operacional do të jetë për 12 muaj duke filluar nga Janar 2024. Qëllimi i grantit është bashkëfinancimi i kostove operacionale për Parkun Natyror Korab-Koritnik (PNKK) në Shqipëri në përputhje me Planin e Menaxhimit.

Kjo për të kontribuar në ruajtjen e biodiversitetit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës të banorëve në Parkun Natyror Korab-Koritnik (PNKK).

Granti nga PONT i jepet Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) në bashkëpunim me Agjencinë Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdZM) në Kukës dhe Dibër me përgjegjësinë e planifikimit dhe drejtimit të zbatimit të masave të projektit në nivel vendor si dhe vendosjen e lidhjeve me aktorët lokalë.

2. Subjekti i aplikimit

Me qëllim rritjen e kapaciteteve për zbatimin e planit operacional për PN Korab-Koritnik, PONT ka dhënë një grant për AdZM Kukës dhe AdZM Dibër, nëpërmjet AKZM, duke përfshirë financimin për punësimin e personelit shtesë në AKZM në Tiranë dhe në AdZM Kukës dhe AdZM Dibër.

AKZM tani fton kandidatët e kualifikuar për pozicionin e mëposhtëm të punës:

- A. 1 Roje Mjedisore/Ranger assistant pranë AdZM Dibër/PNKK

të paraqesin shprehjen e tyre të interesit dhe të dorëzojnë CV-të e tyre dhe dokumentet e tjera mbështetëse siç janë renditur më poshtë në paragrafin 3.

3. Kushtet për aplikim

Personat e interesuar duhet të japin informacionin e tyre duke demonstruar se kanë kualifikimet e kërkuara dhe përvojën përkatëse për të kryer shërbimet sipas kërkesave të ToR-ve, përmes CV-së së tyre dhe dokumenteve të tjera mbështetëse si kopjet e diplomës; kopjet e certifikatave për kurset e trajnimit të ndjekura, studime të tjera pasuniversitare, nëse ka.

- Për pozicionet e shpallura, gjuha e CV-së duhet të jetë shqip dhe CV-ja të jetë e firmosur dhe të tregojë pozicionin për të cilin aplikon kandidati.
- Afati i fundit për dorëzimin e dokumenteve të sipërpërmendura duhet të jetë brenda datës 06 Shtator 2024 – ora 12.00.
- Dokumentet duhet të dorëzohen me postë të rregullt ose personalisht në AKZM: (Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Pozicioni _____). Vëmendje Oficeri i Komunikimit, Adresa: Blvd.Dëshmorët e Kombit, Nr. 1, Tiranë) ose me e-mail në adresën: info@akzm.gov.al.
- Pozicioni për të cilin kandidati po aplikon duhet të shënohet në zarf dhe në subjektin e aplikimit me email.

- Dokumentet e marra pas afatit dhe jo sipas kërkesave të mësipërme, nuk do të merren në konsideratë dhe do të përjashtohen nga konkurrimi.
- Modeli i CV-së është i disponueshëm në Aneksin 2 të kësaj ftese (Ju lutemi referojuni: Aneksit: 1A për Termat e Referencës (ToRs) dhe Aneksit 2 për formularin e CV-së)
- Në rast të shpal ljes fitues, shërbimi do të fillojë menjëherë pas nënshkrimit të kontratës nga të gjitha palët.

Me respekt,
Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura

Annex 1A

TERMAT E REFERENCES

1A. 1 Roje Mjedisore/Ranger pranë AdZM Dibër/PNKK

Autoriteti kontraktues:	AKZM/AdZM Dibër
Burimi i financimit:	Prespa Ohrid Nature Trust PONT
Referenca e buxhetit:	Rezultati 2, Aktiviteti 2.1
Detyra e ekspertit:	Roje mjedisore/ Ranger assistant
Kohëzgjatja:	3 muaj e 16 ditë nga data e kontraktimit, përkohësisht 9 Shtator 2024 – 31 Dhjetor 2024
Input:	Me kohë të plotë për 12 muaj.
Tipi i kontratës:	Kontratë shërbimi 12-mujore,
Vendndodhja:	Punonjësi do të qëndrojë në ZM në AdZM Dibër.
Reporton tek:	Drejtori i AdZM-së. Koordinimi i përditshëm me specialistin e menaxhimit dhe monitorimit.

Hyrje:

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) është autoriteti qeveritar përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të zonave të mbrojtura në Shqipëri. AKZM operon nëpërmjet 12 Administratave Rajonale për Zonat e Mbrojtura (AdZM) të cilat janë drejtpërdrejt përgjegjëse për menaxhimin në terren dhe monitorimin e zonave të mbrojtura brenda territorit të rajonit të tyre. AdZM përbëhet kryesisht nga një sektor monitorimi dhe një sektor menaxhimi i mbështetur nga një numër rojesh të dedikuar për çdo zonë të mbrojtur dhe kryesisht përgjegjës për patrullimin në terren.

Prespa Ohrid Nature Trust (PONT) është një fond mirëbesimi besimi ndërkufitar i krijuar në vitin 2015 nga Fondacioni MAVA dhe nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) me misionin “Ruajtja e natyrës për një të ardhme të qëndrueshme përmes krijimit të partneriteteve dhe mbështetjes financiare afatgjatë”. PONT zbaton misionin e tij nëpërmjet dy programeve kryesore të granteve: (1) bashkëfinancimi i kostove operacionale të Zonave të Mbrojtura dhe (2) bashkëfinancimi i punës së Aktorëve Mjedisorë. Aktorët Mjedisorë përfshijnë organizatat jofitimprurëse (OJF) me fokus mbrojtjen e natyrës, bashkitë, institucionet shkencore dhe akademike. Për më shumë informacion ju lutemi na vizitoni në: www.pont.org.

Zbatimi i grantit 3-vjeçar është në vitin e parë të tij (2024) dhe sipas planit operacional do të jetë për 12 muaj duke filluar nga Janar 2024. Qëllimi i grantit është bashkëfinancimi i kostove operacionale për Parkun Natyror Korab-Koritnik (PNKK) në Shqipëri në përputhje me Planin e Menaxhimit.

Kjo për të kontribuar në ruajtjen e biodiversitetit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës të banorëve në Parkun Natyror Korab-Koritnik (PNKK).

Granti nga PONT i jepet Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) në bashkëpunim me Agjencinë Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdZM) në Kukës dhe Dibër me përgjegjësinë e planifikimit dhe drejtimit të zbatimit të masave të projektit në nivel vendor si dhe vendosjen e lidhjeve me aktorët lokalë.

Me qëllim rritjen e kapaciteteve për zbatimin e planit operacional për PN Korab-Koritnik, PONT ka dhënë një grant për AdZM Kukës dhe AdZM Dibër, nëpërmjet AKZM, duke përfshirë financimin për punësimin e personelit shtesë. AKZM po mbështet punësimin e stafit, menaxhimin dhe ngritjen e kapaciteteve të personelit të sapo punësuar.

Objektivi i punës:

AKZM dhe AdZM janë institucione të reja, prandaj mundësitë, rregullat dhe rregulloret e Zonave të Mbrojtura nuk janë gjithmonë të njohura për vizitorët dhe palët e interesuara rajonale apo lokale. Sektori i monitorimit po mbulon të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me kontrollin dhe parandalimin e aktiviteteve të paligjshme në zonat e mbrojtura, përfshirë informimin e vizitorëve. Roje mjedisore/ Ranger siguron që palët e interesuara rajonale dhe vizitorët të respektojnë rregullat në park. Përveç kësaj, rojtari ofron mbështetje teknike për kërkimin, monitorimin, mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe informacionin e vizitorëve.

Roje mjedisore/ Ranger do të punojë ngushtë me drejtorin e AdZM-s dhe stafin e tij, domethënë rojet e tjerë dhe do t'i raportojë drejtorit. Koordinimi i përditshëm dhe mbikëqyrja teknike është me Përgjegjës të Sektorit të Monitorimit të AdZM-së.

Përmbledhja e detyrave të një Roje mjedisore/ Ranger assistant sipas Rregullore së Brendshme për Organizimin dhe funksionimin e AKZM-së dhe AdZM-së:

Mbikëqyr zbatimin e ligjeve dhe akteve të tjera ligjore për mbrojtjen dhe menaxhimin e burimeve natyrore, biodiversitetit të zonës së mbrojtur:

- Kontrollon dhe patrullon të gjitha aktivitetet dhe shërbimet brenda territorit të zonës së mbrojtur.
- Kontrollon zbatimin e planit të menaxhimit të zonës së mbrojtur dhe (brenda kufizimeve të kompetencave ligjore që i besohen këtij pozicioni) merr masa në rast të shkeljes së objektivave të menaxhimit ose mosrespektimit të aktiviteteve të parashikuara.
- Mbron mjedisin nga dëmtimet, zjarri, insektet dhe sëmundjet, ndotjen e mjedisore, erozioni e tokës dhe ujit, burimet e rëndësishme gjenetike (bimët dhe kafshët) dhe përdorimi/kontrolli i përdorimit të tyre, gjuetia dhe peshkimi.
- Kontrollon zbatimin e rregullave që dalin nga konventat, direktivat, marrëveshjet, projektet dhe programet nën administrimin dhe menaxhimin e zonës së mbrojtur.
- Kontrollon zbatimin e kritereve për ruajtjen dhe rehabilitimin e specieve dhe habitateve të rëndësishme, mbrojtjen e bimësisë, kafshëve të egra dhe veçorive të tjera natyrore kundër dëmtimit ose shkatërrimit, zbatimin e teknikave të menaxhimit ekologjik.
- Kontrollon zhvillimin e aktiviteteve ekonomike në përputhje me menaxhimin e territorit të zonës së mbrojtur.

- Vëzhgon zbatimin e aktiviteteve me leje mjedisore, veçanërisht projektet infrastrukturore dhe vigjilent për ndërtimet pa leje në territorin e zonës së mbrojtur.
- Parandalon, zbulon dhe lufton me anë të raportimit në strukturat përkatëse në AdZM dhe AKZM, dëmtimin, zaptimin, abuzimin, shkatërrimin e mjedisit tokësor dhe ujor, gjuetinë dhe peshkimin me metoda të paligjshme, dëmtimin e pyjeve dhe çdo aktivitet tjetër joligjor.
- Verifikon, evidenton dhe raporton e njofton tek strukturat përkatëse në AdZM (Drejtori i AdZM ose Shefin e Sektorit të Shërbimit të Monitorimit) dhe AKZM për bllokimin ose konfiskimin e veprimtarisë së çdo personi juridik që nuk paguan detyrimet/tarifat ligjore në fushën përkatëse të veprimtarisë së tij ose të çdo mjeti të paligjshëm që përdoret në peshkim apo gjueti.
- Koordinon për detyra specifike teknike me institucionet e tjera aktive në zonën e mbrojtur.
- Përgjegjës për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe mjeteve që janë në dispozicion për realizimin e punëve dhe detyrave, ofron mbështetje teknike për mirëmbajtjen e infrastrukturës përmes monitorimit të gjendjes së tyre.
- Kryen punime të vogla riparimi.
- Mbështet informimin e vizitorëve në terren, përmes shpërndarjes së fletëpalosjeve dhe materialeve të tjera informative dhe merr pjesë në ngjarjet lokale/aktivitetet edukative të organizuara.
- Ofron mbështetje teknike për aktivitetet kërkimore dhe monitoruese të rregullta të Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura dhe siç caktohet nga Përgjegjësi i Sektorit/Drejtori.
- Dokumenton problemet, detyrat e kryera, procesverbalet, mjetet e sekuestruara etj., në një libër shërbimi.

Kryen detyra të tjera në përputhje me funksionin e pozicionit të tij në koordinim të ngushtë me Drejtorin e AdZM-së dhe Shefin e Sektorit të Shërbimit të Monitorimit.

Në vijim të Planit Operacional Vjetor të AdZM-së, me marrjen e detyrës do të hartohet një listë e detyrave të detajuara për 12 muajt e vitit 2024 dhe një plan mujor personal i punës, i cili do të miratohet nga mbikëqyrësi – Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimit të Monitorimit.

Kërkesa të përgjithshme:

- Demonstron integritet duke promovuar vlerat dhe standardet etike të AKZM-së.
- Shfaq ndjeshmërinë dhe përshtatshmërinë kulturore, gjinore, fetare, racës, kombësisë dhe moshës.
- Aftësi në organizimin dhe kryerjen me saktësi të detyrave të shumta, duke vendosur prioritetet dhe duke marrë në konsideratë detyra të veçanta, ndërprerje të shpeshta, afate, burime të disponueshme dhe raportime të shumëfishta.
- Aftësi për të planifikuar, koordinuar dhe organizuar ngarkesën e punës, duke qenë të vetëdijshëm për ndryshimin e prioritetëve dhe afatet kohore.
- Përvojë në krijimin, ndërtimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve efektive të punës me stafin, vizitorët, komunitetin lokal dhe palët e tjera të interesuara.
- Aftësi për të identifikuar mundësi për ngritjen e kapacitetit të stafit.
- Ndjeshmëri dhe përgjegjshmëri ndaj të gjithë stafit dhe bashkëpunëtorëve.

- Aftësi për të mbështetur zbatimin e aktiviteteve, qasjeve dhe ideve të reja dhe për të ndikuar në ndryshimin e sjelljes/qëndrimit të stafit.
- Ndjek mundësitë e zhvillimit profesional të ofruara në kuadër të grantit PONT për PNKK.

Aftësi vetë-menaxhuese

- I fokusuar në rezultat për AKZM-në / AdZM-në.
- I qaset vazhdimisht punës me energji dhe qëndrim pozitiv e konstruktiv.
- Lidërship dhe motivues.
- Mbetet i qetë, në kontroll dhe me humor të mirë edhe nën presion.
- Demonstron hapje ndaj ndryshimeve dhe aftësi për të menaxhuar kompleksitetet.
- Përgjigjet pozitivisht ndaj reagimeve kritike dhe këndvështrimeve të ndryshme.
- Kërkon komente nga stafi për ndikimin e sjelljes së tij/saj.

Kualifikimet

- Minimumi diplomë të shkollës së mesme, kualifikime të tjera, p.sh. çertifikatë profesionale ose bachelor (ka prioritet).
- Njohja e mirë e gjuhës shqipe (me shkrim dhe me gojë), anglishtja apo gjuhë të tjera të huaja kanë përparësi.
- Fizikisht i aftë dhe i gatshëm për punë fizike.
- I apasionuar mbas aktiviteteve në natyrë, duke marrë parasysh kushtet klimaterike.
- Aftësi të mira komunikimi dhe bashkëpunimi në grup.
- Aftësi praktike, p.sh. në rregullimin e pajisjeve teknike, mirëmbajtjen e automjeteve, etj.
- I interesuar për të punuar në PNKK, eksperiencë të mëparshme si roje mjedisore/ranger ose në administrimin e zonave të mbrojtura përbën prioritet.
- Kanë avantazh personat që jetojnë, kanë lidhje ose janë me origjinë nga PNKK.
- Të gatshëm për të punuar edhe jashtë orarit zyrtar të punës.

Aneksi 2 CV form
Pozicioni: *Shënoni pozicionin për të cilin aplikoni*
CURRICULUM VITAE
1. Mbiemri: xxx

2. Emri: xx

3. Ditëlindja: xx

4. Kombësia: xx

5. Gjendja civile: xx

6. Edukimi:

Data (nga – deri)	Institucioni	Diplomat:
Xxx	X	X
Xxx	X	X
Xx	X	x

7. Aftësitë në gjuhët e huaja: Vlerësoni nivelin nga 1 deri në 5 (5 – shkëlqyeshëm; 1 – bazë)

Gjuha	Të lexuarit	Të folurit	Të shkruarit
X	Gjuha amtare		
X			
X			
X			

8. Anëtarësimi në grupe profesional: / xxx

9. Aftësi të tjera:
10. Pozicioni aktual: xxx

11. Vite në këtë pozicion: x years

12. Aftësi kyçe:

- *Përshkruani në detaje*

13. Eksperienca specifike në rajon:

Shteti	Data nga – deri
XXX	Muaji/Viti

14. Eksperienca profesionale

Data nga – deri	Vendi	Kompania	Pozicioni	Përshkrimi
xxx - aktualisht	xx	xx	x	<i>Përshkruani me detaje</i>
xxx - xxxx				•
xxx - xxxx				•
xxx - xxxxxx				•
xxx - xxx				•

15. Informacione të tjera:

data	Titulli i trajnimit/workshopit	Vendi, institucioni
xxx	Xxx	xxx
xxx	Xxx	xxx
xxx	Xxx	xxx
xxx	Xxx	
xxx	Xxx	
xxx	Xxx	

16. Publikime:

Autori (Viti)– Titulli, Gazeta/shtëpia botuese